



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 05 mars 2022, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,

E mbajtur për nderë të Shënimit të “EPOPESË së UÇK-së” dhe ka për qëllim shënimin dhe promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e Familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës

Mbledhja filloi në orën 09;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç Demokrat Hodolli, Arjeta Abazi, Ekrem Rrahmani, Endritë Murati dhe Burim Hasani - (Lista e nënshkrimeve).

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Gjithashtu, me ftesë të Kryetarit të Komunës, në mbledhje të pranishëm ishin edhe familjarë të Heronjve dhe Dëshmorëve të Kosovës, përfaqësues të Organizatave të dala nga Lufta (z.Kadri Ajeti, z.Naim Zhitia, z.Fahri Balaj, z.Ilaz Islami, z.Fadil Mulliqi, z.Kadri Balaj), z.Nijazi Jashari-Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, z.Abedin Zeka-LVV, një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve të Komunës.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë – Himni Kombëtar

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë seancë Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës për nderë të shënimit të “Epopesë së UÇK-së”.

• Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Hilmi Hoxha, theksoi, të nderuar këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, e nderuara Nënkyetare, i nderuar kabinet Ekzekutiv, të nderuar e respektuar përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, të nderuar familjarë të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës dhe përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe qytetarë të pranishëm, të gjithë ju mirë se vini në këtë mbledhje solemne në këtë datë për të shënuar “Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në nderim të Dëshmorëve dhe të rënëve, ju ftoj për 1 minutë heshtje.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të Dëshmorëve dhe të rënëve.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, jemi këtu për të shënuar përvjetorin e “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” e cila pa asnjë ekzagjerim, është formacioni politik dhe ushtarak më i konsoliduar i këtij organizimi të Shqiptarëve të Kosovës. Që nga Lidhja e Prizrenit deri me UÇK-në, organizimet tona nuk kishin kaq gjithpërfshirje dhe kaq impakt për gjithë Kombin tonë.

Pikërisht kjo luftë e madhe e UÇK-së, kjo sakrificë e madhe e familjes Jashari, e cila mbetet rast unik i flijimit, bëri që në marsin e radhës, me 1999, vendet demokratike të NATO-s të intervenojnë ushtarakisht në luftën e Kosovës.

Vlerën e mirëfilltë të çdo personaliteti të shquar të një kombi e tregon më së miri qëndrimi i brezave të mëvonshëm ndaj veprës dhe trashëgimisë që lan pas.

Sa më shumë krijohen distanca historike aq më shumë rritet madhështia e figurës së Adem e Hamzë Jasharit, si luftëtar, si vizionar dhe si lajmëtar se sakrificat e tyre do të mobilizojnë kombin, do të mobilizojnë Shqiptarët në Evropë, Amerikë dhe në gjithë globin.

Rrugëtimi dhe sakrificat e familjes Jashari, pos që gjeti jehonë dhe bëri ndikim shumë të gjerë në hapësirat Shqiptare si dhe në diasporë, përmban flijimin më të veçantë në historinë tonë dhe është e rrallë edhe në historinë e kombeve të tjera.

Flijimi i familjes Jashari, pos që ishte unik në historinë e Kombit tonë, mobilizoj dhe rriti kohezionin e Shqiptarëve gjithandej në botë, edhe sot dhe në të ardhmen dhe përgjithmonë do të mbetet frymëzim, pikë referimi, inspirimi dhe me ndikim për brezat që do të vijnë. Ndikimi dhe kujtimi për familjen do të jetë i përhershëm, për aq kohë sa në botë të ketë Shqiptarë.

Emri, sakrificat dhe mënyra e flijimit të komandant Adem Jashari dhe e pjesëtarëve Jashari do të mbetet përherë pikë referimi si themeltarët e lirisë dhe shtetësisë sonë. Sakrificat e tyre ndryshoi dinamikën e zhvillimit politik dhe ushtarak në Kosovë, ndryshoi qëndrimin ndërkombëtar për Kosovën, sakrificat e tyre ndryshoi historinë e Kosovës, ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve në Kosovë dhe përreth Kosovës.

Kjo trashëgimi historike është një vlerë e veçantë, është vlerë fisnike edhe për historinë më të re të Kosovës, ajo është pjesë e kujtesës sonë të historisë dhe e identitetit tonë Evropian, është themeli i shtetit të Kosovës. Ndaj, UÇK është historia jonë, është lufta jonë, është sakrificat jonë, është kujtesa jonë është krenaria jonë, dhe mbi të gjitha është busulla jonë në rrugëtimin e konsolidimit të shtetit tonë të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Lavdi dhe përjetësi për komandant Adem Jashari dhe të gjithë dëshmorët e Kombit.

Kryesuesi i Kuvendit, Në vazhdim ftoi për një fjalim rasti Kryetarin e Komunës së Podujevës. Shpejtim Bulliqi

- **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**

z.Shpejtim Bulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, e respektuar Nënkryetare, të nderuar asambleistë, të nderuar Ekzekutiv i Komunës, të respektuar përfaqësues të shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, Familje të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës. I respektuari Komandant i Stacionit Policor në Podujevë, të nderuar mysafirë, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave dhe ju të pranishëm të tjerë,

Jemi mbledhur në këtë seancë solemne të Kuvendit Komunal për nder të shënimit të “Epopesë së UÇK-së”, e cila ka për qëllim kujtimin dhe promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës. Jemi sot këtu për të shprehur nderimin dhe mirënjohjen tonë të thellë për veprën dhe sakrificën e jashtëzakonshme të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij, të gjithë Dëshmorëve të Kombit si dhe gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës.

Sot është datë e shënuar për historinë më të re të Kosovës, më datë 5, 6 dhe 7 mars Familja Jashari për lirinë e atdheut luftuan për tri ditë rresht të rrethuar nga të gjitha anët, ata po rezistonin përballë policisë dhe ushtrisë serbe dhe u flijuan tre breza të një familjeje të madhe, e cila me vetëdije të plotë ranë për të vë gurthemelin e lirisë e shtetit.

Kjo nuk ishte hera e parë që po sulmohej kjo familje, por asnjë sulm nuk i zmbrapste e as nuk i dobësonte, por vetëm i forconte në misionin e tyre të lavdishëm, për t’u bërë pjesë historike e lirisë së Kosovës.

Familja Jashari është rasti më sublim, ata janë unik për sakrificën dhe flijimin e tyre. Ata dëshmuar edhe njëherë se liria është më e shtrenjtë se sa jeta.

Beteja e 5, 6 dhe 7 marsit hapi një kapitull të ri për Kosovën, sakrifica e popullit tonë brez pas brezi u përmbyll me luftën çlirimtare në vitet 1998 - 1999.

Familja Jashari e bëri popullin bashkë duke i vetëdijësuar ata se liria don sakrificë dhe rezistencë. Me luftën dhe rënien e tyre, UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare, diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të Shqiptarëve.

Liria që ne e gëzojmë sot, para së gjithash është produkt i heroizmit të Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit. Faktor tepër i rëndësishëm ishte edhe internacionalizimi i çështjes së Kosovës, ndihma e vendeve mike dhe ndërhyrja e NATO-s kundër Serbisë, për të cilën si përfaqësues dhe si qytetarë të Republikës së Kosovës do t’u jemi mirënjohës gjithmonë që u gjinden pranë nesh në kohët më të vështira.

Të dashur qytetarë, gjithmonë, e në ditë si këto duhet të jemi të kujdesshëm ta vlerësojmë e përkujtojmë përherë gjakun e Dëshmorëve dhe sakrificat e popullit tonë. Kujtimi për sakrificën e Familjes Jashari, Dëshmorëve të Kombit dhe gjithë atyre që ranë për lirinë e vendit, na udhëzojnë për punë të mira, për ecje të drejtë dhe rruga jonë duhet të jetë rrugë e forcimit të Republikës së Kosovës dhe realizimit të idealit të Dëshmorëve të Kombit.

I bekuar qoftë kujtimi për Familjen Jashari dhe gjithë Dëshmorët, martirët e Kombit dhe gjithë atyre që punuan për lirinë e Kosovës. Lavdi e nderime përjetë!

Kryesuesi i Kuvendit, tani ftoj për një fjalë rasti z.Fahri Balaj, përfaqësues i Shoqatave të dala nga lufta.

- **Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së**

z.Fahri Balaj, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, e hapi fjalimin duke i përshëndetur të pranishmit, theksoi, historia Shqiptare është histori përpjekjesh të pareshtura për t'u çliruar nga sundimi i huaj, e tillë është edhe ajo që kulmoj në "Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës" me luftën dhe sakrificën sublime të Familjes Jashari dhe se kjo përpjekje si pak të tjera i'a hapi sytë popullit dhe botës.

"Epopëja e UÇK-së" dëshmoi se populli Shqiptar nuk duron më, se lufta është e pashmangshme dhe se shtypja represive serbe duhet të ketë një fund.

Sakrifica e Familjes Jashari zgjoi edhe më të përgjumurit, gatishmëria e tyre për të rënë për liri dhe bashkim Kombëtar si e tillë është e rrallë në historinë më të lavdishme të popujve për liri dhe këtë histori duhet t'ua mësojmë fëmijëve tanë si shembull i jashtëzakonshëm i atdhedashurisë dhe vlerës së lirisë.

Për fund, të nderuar të zgjedhur të popullit, i nderuari Kryetar i Komunës, të nderuar Ekzekutiv i Komunës, kam kërkesë në emër të të gjithë veteranëve që juve që i'u është dhënë mundësia që të jeni këtu falë luftës dhe sakrificës së pandërprerë nëpër breza, keni rastin që të bëni punën që nesër të mos gjykojeni për mos punë, por të vlerësoheni për punën që keni bërë, shfrytëzoheni sepse moshatarët e juaj nuk e patën këtë fat.

Përrulje dhe nderim i përhershëm ndaj veprës së Familjes Jashari dhe gjithë të rënëve për liri. Lavdi.

***Kryesuesi i Kuvendit**, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në këtë seancë, e mbylli/përfundoi këtë mbledhje.*

Mbledhja përfundoi në ora 09:30

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0016710/22

Podujevë,

05 mars 2022

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha